




ENVER HADRI
2. 4. 1941 - 25. 2. 1990

Enver HADRI u lind në Pejë më 2 prill 1941. Të parët e tij, si duket, në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u shpërngulën nga sanxhaku i Nishit në Pejë.

Babai i Enverit, Islam HADRI, me të atin dhe dy miq shtëpie u vra nga pushtuesit jugosllavë më 1944 duke lënë prapa vetes Enverin 3 vjeçar dhe një vajzë gjashtëmuajshe.

Shkollën fillore dhe të mesme Enver HADRI i mbaroi në Pejë, ndërsa disa vite studioi arkitekturën në Beograd dhe Lubjanë.

Më 1972 me rastin e arrestimit të disa pjesëtarëve të një organizate patriotike Enver HADRI rrezikohet dhe detyrohet të arratiset në Belgjikë, ku iu pranua statusi i refugjatit politik.

Më 25 shkurt, në ora 13 Enver HADRI shkoi ta vizitojë va- rrin e së ëmës që i kishte vdekur 5 muaj më parë në Bruksel, prej ku kthehet në shtëpi rreth orës 16 për të dalur sërish gjysmë ore më vonë, Hipën në makinë, del prej rrugës L'Albania, ku banonte prej shumë kohësh, në rrugën St. Bëmar me ç'rast frenon te udhë- kryqi duke pritur dritën e gjelbër të semaforit, në atë rast një makinë e parakalon në anën e tij të majtë, ndalet paralelisht me të dhe nga dritarja e saj shtien me revoie duke e goditur Enver HADRIN me 3 plumba në kokë.

I plagosur për vdekje nga vrasësit e Serbisë Enver HADRI vdiq në ora 19 në spitalin qendror të Brukselit.

VRASJE MIZORE NE BRUKSEL (Në kujtim të ENVER HADRIT)

Bashkatdhetarë

Në kohën kur populli shqiptar në Jugosllavi akoma nuk ka përfunduar t'i va- rrosë viktimat e fund'd të terrorit shtetëror në Kosovë, në kohën kur anë e kënd viseve shqiptare u hapën varret e reja për martirët më të rinj të Lirisë, të Barazisë e të Demokracisë armiq të përбетuar të kombd tonë, mizorët serbomëdhenj e vranë në pikë të ditës e në mes të Evropës shokun tonë të halleve e të përpjekjeve

ENVER HADRIN

Kriminelët e UDB-së gjakatare vranë mildantin e palodhshëm, demokratin e vërtetë dhe denoncuesin e vendosur të shkëljes së të drejtave të njeriut, i edi gjithë jetën e tij u përpoq për të mirën e popullit e për lirinë e Kosovës.

Shumë kohë para vlimeve të mëdha në Lindje, shumë kohë para se kontinentin e Vjetër ta përshkonte fryma aktuale liridashëse e antitiranike, shumë kohë para se të binin si kungujt e kalbur zotërinjtë gë në vend të mirëqenies impononin urinë, në vend të lirisë burgjet e dajakun, në vend të demokracisë errësirën e demagogjinë, Enver HADRI ishte ndër të parët që i hetoi këto erëra shpëtimtare për popujt dhe për vegjëlinë.

Veç kësaj, Enveri ishte i rraiië ndër shqiptarë që me kohë e kuptoi rëndësinë strategjike të Bashkësisë Evropiane edhe për vetë çështjen e popullit tonë, prandaj u koncentrua kryesisht në informimin objektiv për Kosovën të deputetëve të Parlamentit Evropian dhe të përfaqësuesve të Bashkësisë Evropiane. Kështu që nuk është çudi pse vetëm brenda një viti ky, aktualisht, më i rëndësishmi institucion ndërkombëtar të apro- vojë dy rezoluta shumë të rëndësishme në të cilat ai vihet hapur në anën e popullit të shtypur shqiptar dhe denoncon praktikën e dhunës që po e zbaton kundër nesh klani luftënxitës serb i udhëhequr nga Milloshe viqi.

Përmes Komitetit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë, Enver HADRI arriti të vërë kontakt të drejtpërdrejtë me shumë personalitete të shquara poli- tike evropiane, të kontaktojë me gazetarë e deputetë, me parti e lëvizje të të ndrysh- me politike.

Enver HADRI ishte ndër të parët në diasporën e Kosovës në mërgim që kuptoi drejlë dallimin kardinal në mes informimit kualitativ e kuantitativ, në mes veprimi të zhurmshëm po steril dhe në mes punës në heshtje por me vlerë. Pikërisht për këtë ai sidomos këto dy vitet e fundit arriti rezultatet të konsiderueshme në shpjegimin në botë të së vërtetës për Kosovën.

Për shkak të natyrës së njëjtë të veprimtarisë, ne, aktivistët e Komitetit të Kosovës për Informimin e Opinioni Botëror kemi bashkëpunuar ngusht me Enver HADRIN dhe përshtypja jonë për të si shqiptar, si njeri e si militant ka qenë dhe ka

mbetur kjo:

Enver HADRI ishte njeri modest. Ai ka qenë ndër njerëzit e rrallë në emigracion që ka krijuar emër pa pasur kurrëfarë ambicjesh personate. Në këtë kuptim ka bërë përpjekje të përhershme e të singlerla që, me qëllim të një veprimi të përbashkët, të vijë gjer te një koordinim i veprimtarisë së të gjithë shqiptarëve në mërgim. Ai çdo shqiptar, pavarësisht nga bindjet e tij poli tike, e ka konsideruar si pjesëtar të familjes së madhe që përbën Kombin tonë. Dbe në këtë frymë është përpjekur me çdonjërin të gjejë gjuhën e përbashkët të vëllezërve.

Si njeri me përgatitje intelektuale e kulturore të gjerë politike Enver HADRI, ndër të paktët shqiptarë në mërgim, ka arritur të gëzojë një autoritetet të pakontestueshëm te garqet politike të shumë shteteve evropianoperëndimore.

Pikërisht për këto që u thanë UDB satanike ka përgatitur kaheër terrenin për eliminimin e Enver HADRIT. Të përmendim traktin që ajo botoi vitin e kaluar në shtypin serb në emër të viktimës së saj të ardhshme. Në trakt ndodheshin emrat e shumë njerëzve në Kosovë (shqiptarë e serbë), të cilët gjoja Enver HADRI me sbokë e paskësh pasur ndër mend t'i likuidojë.

Meqë fjala ishte për një fabrikim të UDB-së Enver HADRI nuk e pa të nevoj- shme ta demantojë këtë duke menduar se ne nuk kemi kohë të merremi me paçavuret e UDB-së por të punojmë ditë e natë dbe ta zhveshim këtë organizëm kriminal policor para gjithë opinionit ndërkombëtar që që do të ishte vdekja më e tmershme e UDB-së dbe e të gjitha qyqeve e korbave që janë vënë shërbim të saj.

Përkundër të gjithave që u thanë, megjithatë sërish sbtrobet pyetja pse UDB e vrau Enver HADRIN? A mos e vrau pse ai organizoi ndonjë komplot kundër Serbisë prej këlu? Jo. E vrau sepse Enver HADRI ishte realist, sepse Ai e kishte kuptuar me kohë që emigracioni kurrë nuk mund të ketë roi vendimtar në çlirimin e një populli të shtypur, por mund të luajë roi të rëndësishëm në radhë të parë duke u bërë përpjekjeve të tij sa më shumë mijë e përkrahës në botë.

Enver HADRIN pra e vrau Serbia vetëm pse u bë te opinionin i huaj dhe te institucionet më të rëndësishme ndërkombëtare denoncues i vendosur i shkeljes sistematike të të drejtave të njeriut në Kosovë. Pikërisht për këtë Enver HADRI ishte kundërshtari më i rreziksbëm i regjimit aktual serb, sepse regjimet e egra, që jo vetëm ushqehen me idetë Mesjetës, por edhe që përdorin mjetetet e atëhershme të hakmarrjes e të dhunës, veprimi intelektual i zhvesh si mos më keq dhe nuk u jep as shkakun më të vogël për përdorimin e dhunës me të cilën ata jetojnë dhe mbahen në pushtet.

Këto ditë kur krejl Kosova është në këmbë, këto ditë, kur populli ynë po tre- gon një pjekuri të pabesueshme politike e organizative, vrasja e Enver HADRIT është një humbje akoma më e madhe, sepse duhet ta pranojmë me dhimje të pafund se Enver HADRIN tash për tash nuk mund ta zëvendësojë askush, e pikërisht insistuioni ku ka qenë e koncentruar gjithë veprimtaria e tij ka rëndësi shumë të madhe. Aty është epi- gendra politike dhe ekonomike e Evropës, ndikimi mbi të cilën ka rëndësi të madhe për të ardhmen e popullit tonë.

Të mos harrojmë se për të fituar përkrahjen e Bashkësisë Evropiane në poho

det e tij antishqiptare, Miilosheviqi dërgoi aty si ambasador nërin prej bashkëpunëtorë- ve të tij më të ngushtë, Cërnobërnjen, por as ky nuk qe dorëmbarrë, kështu që policia serbe erdhi në përfundim se pikërisht Enver HADRIT është bërë pengesa kryesore e dësh- timeve të njëpasnjëshme të politikës serbe oë Strasburg e Bruksel. Kështu që nuk gjeti rrugë tjetër veçse ta eliminojë fizikisht. E për këtë nuk e pati vështirë sepse me të gjitha strukturat e policisë në Jugosllavi udhëheg antishqiptari i përbetuar, ish shefi i shtatmadhorisë jugosllave, gjenerali Petar Graçanin.

Vrasja mizore e Enver HADRIT është edhe një dëshmi tjetër se politika serbe ndaj shqiptarëve nuk është politika e dialogut dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, por prak- tika e dajakut, e arrogancës dhe e krimit të hapur. Kjo është një shenjë tjetër për vërshime të reja të gjakut të pastër të arbërit, i cili nuk synon tjetër veçse të jetojë në miqësi e vëllazëri jo vetëm me popujt fqinj por me të gjithë popujt e botës. Ky synim i shenjtë e i ndritshëm për të cilin flijuan jetën e tyre bijtë më të mirë të Nënës Kosovë është në prak të fitores, sepse për të e derdhi dhe po e derdh pa kursim gjakun populli ynë trim sikundër gë e derdhën bijtë e tij të arratisur goftë dikur në Selanik e në Bari, goftë sot në Stutgart e në Bruksel.

Prandaj në përpjekjet e tij patriotike e humaniste kurrë nuk do të mundë ta frikësojnë dhe ta ndalin shqiptarin as mizoria e armigve e as ligësia e tradhtarëve.

Do të rrojë në jetë të jetëve kujtimi i ndritshëm i martirit më të ri të Kosovës, i patriotit dhe veprimtarit të palodhshëm Enver HADRIT

KOMITETI I KOSOVES PER INFORMIMIN E OPINIONIT BOTEROR

**C. P. 355 3072 Om. 2 Zvicër
27 shkurt 1990**

Shfrytëzojmë nga rasti t'i informojmë të gjithë të interesuarit se varrimi i Enver HADRIT do të bëhet të shtunën, më 3 mars 1990, në ora 9 në varret e guajtura "Cimetiers des FARCENNES" në Bruksel.

Kështu që funerali do të nisët prej shtëpisë së të ndjerit, në Rue de l'ALBANIE, nr. 23, në ora 8 e 30 të mëngjesit, për shkak se varrezat janë të hapura vetëm gjër në ora 12.

Prej Stacionit të Trenit e në Rue de l'ALBANIE shkohet me tramvajin nr. 81.

I vëmë në dijeni të gjithë bashkatdhetarët se të njëjtën ditë pasdite do të mbahet një tubim protestues para Ambasadës jugosllave dhe para institucioneve belge e ndërkombëtare në Bruksel.

Prandaj të jemi sa më shumë njerëz dhe ta nderojmë në mënyrë dinjitoze kujtimin e bashkëluftëtarit dhe bashkatdhetarit tonë dhe publikisht jo vetëm ta dënojmë këtë krim mizor, por edhe të kërkojmë prej atyre gë i dhanë strehimin politik Enver HADRIT gë me çdo kusht t'i zbulojnë vrasësit e tij dhe t'i këpusin të gjitha marrëdhë- niet me autoritetet jugosllave gë urdhëruan këtë krim të shëmtuar politik.